



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 44, datë 13.01.2024

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “PSIKOLOGJI”, TË UNIVERSITETIT TË NEW YORK-UT NË
TIRANË

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 224, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 13.01.2024, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Psikologji”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në “**Psikologji**”
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 209, datë 03.07.2020
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti i New York-ut në Tiranë
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Psikologjisë
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite / 6 semestra
- g) Kredite (ECTS): 180 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht
- j) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti i New York-ut në Tiranë
- k) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të parë “Bachelor”*” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush pjesërisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:
 - 1. Kualifikimi i disa prej titullarëve të lëndëve të këtij programi studimi, nuk është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
 - 2. Fusha e ekspertizës e disa prej anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, nuk është plotësisht në përputhje me lëndët që ata japin në këtë program studimi.
 - 3. Ngarkesa mësimore e disa prej anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, është e lartë.
 - 4. Mungesa në kurrikulën e këtij programi studimi e disa prej lëndëve të përmendura nga grupi i vlerësimit të jashtëm në raportin e vlerësimit të jashtëm.
 - 5. Mungesa e përcaktimit të koordinatorit të këtij programi studimi, sikurse parashikohet në aktet ligjore e nën ligjore në fuqi.
 - 6. Procedura e vlerësimit në përmbyllje të studimeve për studentët e këtij programi studimi, është e pa qartë dhe jo objektive.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:


1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Bachelor në “Psikologji”, të Universitetit të New York-ut në Tiranë.
2. Akreditimin e programit të studimit me kohëzgjatjen prej 2 (dy) vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **12.01.2026**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar

DARINKA PIQANI




Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 44, datë 13.01.2024, "Për akreditimin e parë të programit të studimit Bachelor në "Psikologji", të **Universitetit të New York-ut në Tiranë**, janë si vijon:

1. Institucioni, të marrë masa që kualifikimi i titullarëve të lëndëve të këtij programi studimi, të jetë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
2. Institucioni, të marrë masa që fusha e ekspertizës e anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, të jetë plotësisht në përputhje me lëndët që ata japin në këtë program studimi.
3. Institucioni, të marrë masa për uljen e ngarkesës mësimore të disa prej anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, për të cilët rezultoni e lartë.
4. Institucioni, të rishikojë kurrikulën e këtij programi studimi në përputhje me rekomandimet e lëna nga grupi i vlerësimit të jashtëm në raportin e vlerësimit të jashtëm.
5. Institucioni, të marrë masa për përcaktimin e koordinatorit të këtij programi studimi, në përputhje me parashikimet ligjore e nën ligjore në fuqi.
6. Institucioni, të marrë masa që procedura e vlerësimit në përmblyllje të studimeve për studentët e këtij programi studimi, të jetë e qartë dhe objektive.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti i New York-ut në Tiranë**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

